



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 28.5.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Abdyl Salihu, Mufera Shinik dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Mungoi: Verica Çeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtim i projektligjit nr. 06L/046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtim i projektligjit numër 06L/046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Ismajl Kurteshi tha se si Komision kemi punuar gjatë në këtë projektligj për të ardhur deri në këtë fazë. Ai tha se ka mbetura që zyra ligjore të paraqes dy propozime lidhur me çështjet që kanë mbetur për diskutim, formimi i komisioneve të jetë kompetencë e drejtorit të përgjithshëm të inspektoratit apo të ministrit të Arsimit si dhe çështja mbi mbikëqyrjen e punës së inspektorëve.

Teuta Haxhiu tha që komisioni ka punuar dhe diskutuar gjatë që me anë të këtij ligji inspektorati të ketë fuqi profesionale më të madhe. Ajo tha që sa i përket formimit të komisioneve, duhet drejtori i përgjithshëm të ketë këtë kompetencë, pasi që ministri ka fuqi politike. Dhe shtoi që nuk pajtohet me faktin që drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të ketë mandat të përhershëm.

Valentina Bunjaku – Rexhepi tha meqë është vendosur që Inspektorati të funksionojë si organ i ministrisë, atëherë kompetenca mbi formimin e komisioneve duhet t'i takojë drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit. Ajo gjithashtu tha që inspektorati duhet të fuqizohet më shumë pasi që ka mungesë të inspektorëve.

Ismajl Kurteshi tha se fjala është për dy shkallshmërinë e ankesës, ku shkalla e parë është drejtori, ndërsa shkalla e dytë është ministri. Në rast se, drejtori merr vendim përfundimtar atëherë nuk mund të ketë dy shkallshmëri. Ai tha se meqenëse drejtori gëzon mandat të përhershëm, ekziston mundësia që ai t'i zgjedhë të njëjtit, kështu që mendon se ministri duhet ta ketë kompetencën e formimit të komisionit të ankesave.

Nezir Çoçaj deklaroi që e drejta e formimit të komisioneve duhet t'i takojë drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit, pasi që inspektorati ka nevojë për fuqizim.

Arbërie Nagavci tha se sa i përket çështjes së formimit të Komisioneve përkrah propozimin që këto komisioni të formohen nga ministri, pasi që konsideron se formimi i tyre nga drejtori i Përgjithshëm është në kundërshtim me parimet bazë juridike sa i përket dy shkallshmërisë së shqyrtimit të ankesave.

Pas diskutimeve për këtë çështje, anëtarët e Komisionit me shumicë votash vendosën që kompetenca për formimin e komisioneve t' i takojë drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit. Në këtë proces 6 deputetë votuan në favor të drejtorit, ndërsa 4 të tjerë në favor të ministrit.

Arbërie Nagavci tha që të sigurohet cilësi më e madhe në arsim, duhet bërë vlerësimi i performancës së inspektorëve. Ajo propozoi që të gjithë inspektorët t' i nënshtrohen një provimi

shtetëror ku do të bëhet matja e njohurive profesionale dhe përgatitja e inspektorëve për pozitën që mbajnë.

Propozimi i deputetes Nagavci u hodh në votim, anëtarët e komisionit me shumicë votash nuk e përkrahën propozimin që inspektorët t'i nënshtrohen provimit shtetëror për vlerësimin e performancës së inspektorëve, me arsyetimin se ekziston një komision që vlerëson punën e tyre, si dhe janë kriteret e përzgjedhjes së inspektorëve në bazë të ligjit për shërbyesit civilë.

Pas shqyrtimit të këtyre dy propozimeve, kryetari kërkoi që komisioni të deklarohet me votim të amendamenteve për Projektligjin për Inspektorat të Arsimit.

Anëtarët e Komisionit miratuan unanimisht amandamntet e propozuara, dhe vendosën që raporti me amendamente për Projektligjin për Inspektorat të Arsimit t'i dërgohet Komisioneve të përhershme për shqyrtim.

Amendamenti 1

Në tekstin e preambulës pas fjalës ”Kosovës,” fshihet fjala ”miraton:”

Amandamenti 2

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Ky Ligj përcakton kompetencat, përgjegjësitë dhe organizimin e Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës.

Amandamenti 3

Neni 2, riformulohet si në vijim:

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Ligj trajton mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime edukative, arsimore dhe aftësuese.

Amandamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.3, fshihet teksti ”ose të trajnimit”

Amandamenti 5

Neni 3, nënparagrafi 1.14 riformulohet si në vijim:

1.14.Inspektor i arsimit – person zyrtar i Ministrisë, i cili ka mandat për inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet dhe në gjuhët që zhvillohet arsimit në Kosovë;

Amandamenti 6

Neni 3, nënparagrafi 1.19 dhe 1.20 riformulohen si në vijim:

1.19 Vlerësimi – i referohet proceseve që përdoren për të grumbulluar, analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e arritjeve individuale në mësimdhënie, praktikë profesionale të udhëheqjes së institucionit arsimor dhe arritjes së pritshmërive nga institucioni arsimor.

1.20. Performanca – tërësia e punës dhe rezultateve të punës së mësimdhënësve, drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve dhe institucioneve arsimore, në kuadër të kompetencave për mësimdhënës, standardeve të praktikës profesionale për drejtorë të shkollave dhe kritereve të cilësisë së shkollës.

Amandamenti 7

Neni 3, nënparagrafi 1.21 fshihet.

Amandamenti 8

Neni 3, nënparagrafi 1.22 fshihet teksti ” (ose MASHT)”

Amandamenti 9

Neni 3, nënparagrafi 1.23, 1.24, 1.25 dhe 1.26 fshihen.

Amandamenti 10

Neni 3, nënparagrafi 1.28 riformulohet si në vijim:

1.28. Staf profesional i institucionit arsimor – pedagogët, psikologët, punëtorët social dhe bashkëpunëtorët profesional;

Amandamenti 11

Neni 3, nënparagrafi 1.29 dhe 1.30 fshihen.

Amandamenti 12

Neni 3, nënparagrafi 1.31 riformulohet si në vijim:

1.31. Fushat e cilësisë së institucionit arsimor - segmentet kryesore të veprimtarisë së institucionit/shkollës që do të shërbejnë si pika referuese për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në Kosovë, duke siguruar koherencë në mes të procesit të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës;

Amandamenti 13

Neni 3, nënparagrafi 1.32 riformulohet si në vijim:

1.32.Korniza për sigurimin e cilësisë – politikë arsimore që përcakton kriteret e cilësisë së performancës së institucionit arsimor, procedurat e zbatimit, nivelet dhe shkallet e cilësisë.

Amandamenti 14

Neni 3, nënparagrafi 1.35, 1.36, 1.38 dhe 1.39 fshihen.

Amandamenti 15

Neni 3, pas nënparagrafit 1.40, shtohet nënparagraf i ri më këtë përmbajtje:

Paneli i Artë – Komision i Inspektoratit të Arsimit, i cili merret me shqyrtimin e ankesave në shkallë të dytë në procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.

Amandamenti 16

Neni 4 paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

1. Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit të MASHT-it.

Amandamenti 17

Neni 4, paragrafi 2, fshihet.

Amandamenti 18

Neni 4, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

3. Selia qendrore e Inspektoratit të arsimit është në Prishtinë dhe ka sektorët e vetë në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Gjiilan, Gjakovë.

Amandamenti 19

Neni 5 riformulohet si në vijim:

Neni 5

Funksionet e Inspektoratit të Arsimit

1. Inspektorati i Arsimit kryen këto funksione:

1.1 Funksionin vlerësues – vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore.

1.2 Funksionin kontrollues – kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

1.3 Funksionin këshillues – këshillon drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve arsimore.

1.4 Funksionin informues/raportues – informon ministrin, DKA-të dhe institucionet arsimore për gjetjet e inspektimit si dhe i publikon ato në baza vjetore.

1.5 Funksion mbështetës për promovimin e praktikave të suksesshme të institucioneve arsimore dhe zhvillimin e politikave arsimore.

2. Detyrat për kryerjen e këtyre funksioneve përcaktohen me akt nënligjor.

Amandamenti 20

Neni 7, titulli i nenit, paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.1 riformulohet si në vijim:

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit janë:

1.1. Planifikon, organizon, mbikëqyrë dhe udhëheq punën e Inspektoratit të Arsimit.

Amandamenti 21

Neni 8, riformulohet si në vijim:

1. Ekzistojnë gjashtë (6) lloje të inspektimit në arsim:

1.1 Inspektimi i përgjithshëm;

1.2. Inspektimi tematik;

1.3. Inspektimi emergjent;

1.4. Ri-inspektimi;

1.5. Inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për procesin e licencimit.

1.6. Inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit.

2. Inspektimi i përgjithshëm:

2.1. Inspektimi i përgjithshëm është inspektim i planifikuar që përfshin të gjitha aspektet e cilësisë së institucioneve arsimore;

2.2. Intervalet e inspektimeve të përgjithshme përcaktohen me akt nënligjor të MASHT-it;

2.3. Inspektimet e përgjithshme duhet të paralajmërohen DKA-të dhe shkollat të paktën pesë (5) ditë pune më herët;

2.4. Inspektimi i përgjithshëm përfshin:

2.4.1. Inspektimin administrativ: Kontrollimi i pajtueshmërisë së punës së të gjitha institucioneve arsimore në Kosovë me legjislacionin e aplikueshëm, në intervale të rregullta kohore të përcaktuara nga MASHT, nga inspektorët administrativë. Inspektimi administrativ organizohet në të gjitha nivelet e arsimit;

2.4.2. Inspektimi pedagogjik: Vlerësimi i jashtëm i performancës së institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar. Inspektimi pedagogjik organizohet sipas niveleve të institucioneve arsimore:

2.4.2.1. Institucionet parashkollore;

2.4.2.2. Institucionet e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ultë;

2.4.2.3. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë dhe SNKA 4.

3. Inspektimi tematik:

- 3.1.MASHT, DKA-të, organet udhëheqëse dhe drejtuese të institucioneve arsimore, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit mund të kërkojnë inspektime tematike për çështje specifike të natyrës administrative ose pedagogjike, në pajtueshmëri me këtë Ligj;
- 3.2.Inspektorati i Arsimit, planifikon dhe realizon inspektime tematike, të pa paralajmëruara.

4. Inspektimi emergjent:

4.1.Inspektimi emergjent është një lloj i inspektimit administrativ që ndërmerret në raste të situatave të papritura që rrezikojnë funksionimin e mirë të institucioneve arsimore.

4.2.Inspektorati i Arsimit obligohet të adresojë probleme të tilla menjëherë për të vendosur nëse problemi i hasur është në fushëveprimin e tij, ose, nëse një organ tjetër është përgjegjës, të kontaktojë organin përkatës.

5.Ri-inspektimi - inspektim kontrollues në institucionin arsimor të inspektuar më parë me qëllim të verifikimit se sa janë zbatuar dhe realizuar rekomandimet e dhëna nga ekipi inspektues.

6. Inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për procesin e licencimit - Vlerësimi individual i mësimdhënësve për nivelin e përmbushjes së standardeve të performancës për rilicencim apo avancim në karrierë.

7. Inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit - Vlerësimi i performancës së drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit arsimor parauniversitar i referohet standardeve të praktikës profesionale për drejtorë të shkollës, përkatësisht nivelit të përmbushjes së tyre për vazhdimin e kontratës së punës.

Amandamenti 22

Neni 9 riformulohet si në vijim:

Neni 9

Personeli i Inspektoratit të Arsimit

1.Të punësuarit në Inspektoratin e Arsimit janë shërbyes civil. Për punën e tyre i përgjigjen udhëheqësve të sektorëve përkatës dhe drejtorit të përgjithshëm.

2. Inspektorët e arsimit zgjedhën në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbimin Civil. Përveq kushteve të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe këto kritere:

2.1.Të kenë së paku titull master (300 ECTS);

2.2. Të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në arsim.

2.3. Të mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit,

3. Kandidatet për Inspektor administrativ, pedagogjik si dhe vlerësim të performancës duhet t'i plotësojnë këto kritere:

3.1.Të kenë titull master të fushës përkatëse (300 ECTS),

3.2. Të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në fushën përkatëse,

3.3. Inspektorët për vlerësimin e performances së mësimdhënësve, drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve duhet të kenë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në arsim.

Amandamenti 23

Neni 10, paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

1. Inspektori administrativ është përgjegjës për të mbikëqyrë dhe vlerësuar nëse institucionet arsimore zbatojnë legjislacionit në fuqi.

Amandamenti 24

Neni 10, paragrafi 2, teksti “**Detyrat e përgjithshme të ndërlidhura me të gjitha institucionet arsimore**” zëvendësohet me tekstin “**Detyrat e përgjithshme të inspektorit administrativ të ndërlidhura me të gjitha institucionet arsimore janë:**”

Amandamenti 25

Neni 10, nënparagrafi 2.4. riformulohet si në vijim:

2.4. Shqyrton ankesat e nxënësve, të prindërve dhe të studentëve lidhur me të gjitha llojet e diskriminimit.

Amandamenti 26

Neni 10, paragrafi 3 teksti “**Detyrat specifike të ndërlidhura me institucionet arsimore të nivelit SNKA 0-4**” zëvendësohet me tekstin “**Detyrat specifike të inspektorit administrativ të ndërlidhura me institucionet arsimore të nivelit SNKA 0-4 janë:**”

Amandamenti 27

Neni 11, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2 riformulohen si në vijim:

2.1. të vlerësojë përparimin dhe cilësinë e zbatimit të kurrikulës në të gjitha fushat lëndore;

2.2. të vlerësojë aspektin pedagogjik të mësimdhënies dhe të vlerësimit;

Amandamenti 28

Neni 11, pas nënparagrafit 2.2 shtohet nënparagraf i ri më këtë përmbajtje:

2.3. të vlerësojë cilësinë dhe realizimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) për fëmijët me aftësi të kufizuara;

Amandamenti 29

Neni 11, nënparagrafi 2.3 dhe 2.4 riformulohen si në vijim:

2.3. të vlerësojë materialet dhe mjetet e konkretizimit për mësimdhënie dhe të nxënë dhe përdorimi i tyre i përshtatshëm;

2.4. të kontrollojë dhe të vlerësojë funksionimin e këshillave të prindërve, këshillave të nxënësve, këshillave të mësimdhënësve dhe organeve të tjera profesionale;

Amandamenti 30

Neni 12 riformulohet si në vijim:

Neni 12

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësit, drejtorit dhe zëvendësdrejtorit

1. Inspektori i arsimit duhet që vlerësimin e performancës së mësimdhënësit, drejtorit dhe zëvendësdrejtorit ta realizoj në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Inspektori i arsimit mbledhë të dhëna nga të gjithë komponentët e sistemit të vlerësimit të performancës dhe përcakton nivelin e performancës.
3. Mbikëqyrë aspektet teknike dhe profesionale të procesit, si përpilimin e orarit të vlerësimit, realizimin e monitorimit në orën mësimore dhe bën vlerësimin e planit dhe përgatitjes së njësive mësimore.
4. Përgatit raport përfundimtar të vlerësimit të performancës së mësimdhënësit dhe rekomandon përtrirje të licencës, avansim në karrierë apo revokim të licencës së mësimdhënësve.
5. Përgatit raport përfundimtar të vlerësimit të performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit dhe rekomandon DKA-në për vazhdim, mos vazhdim apo ndërprerje të kontratës.
6. Mbikëqyrë procesin e licencimit të mësimdhënësit, drejtorit dhe zëvendësdrejtorit në të gjitha fazat e tij.
7. Licencimi dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësit, drejtorit dhe zëvendësdrejtorit rregullohet me akt nënligjor.

Amandamenti 31

Neni 13 nënparagrafi 1.6 riformulohet si në vijim:

1.6 Të urdhërojë kualifikimin e mëtejshëm apo të iniciojë procedurat për shkarkim apo rrimërim të drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, stafit profesional dhe mësimdhënësve që nuk posedojnë kualifikimet e nevojshme për punësim në pozitat aktuale si dhe ata që nuk kanë treguar performancë të duhur duke respektuar aktet tjera ligjore në fuqi;

Amandamenti 32

Neni 13 nënparagrafi 1.9 riformulohet si në vijim:

1.9. Të ndërpres punën e institucioneve arsimore që janë të pa licencuara, institucioneve që nuk i plotësojnë standardet dhe kriteret e parapara me ligj.

Amandamenti 33

Neni 13, nënparagrafi 1.12 kalon pas nënparagrafit 1.10 dhe riformulohet si në vijim:

1.11. Të urdhërojë ndërprerjen e shfrytëzimit të materialeve dhe mjeteve të konkretizimit për mësimdhënie dhe të nxënë, nëse ato nuk janë të përshtatshme për moshën e fëmijëve, për kontekstin shoqëror apo për zbatimin e kurrikulës,

Amandamenti 34

Neni 14 riformulohet si në vijim:

1. Për të gjitha inspektimet hartohet procesverbali në të cilin konstatohet gjendja faktike dhe propozohen masat e afatizuara për mënjanimin e lëshimeve.

2. Pas përfundimit të inspektimit administrativ hartohet raporti për të gjeturat e inspektimit i cili përmban: përshkrimin e të gjeturave, konstatimet, rekomandimet e afatizuara për zbatimin e masave të sugjeruara dhe kohën e ri inspektimit:

2.1. Raporti i dorëzohet institucionit të inspektuar, në rastin e inspektimit të institucioneve të arsimit parauniversitar raporti i dorëzohet edhe DKA-së përgjegjëse ndërsa në rastin e inspektimit të institucioneve të arsimit të lartë raporti i dorëzohet edhe Rektoratit.

2.2. Nëse institucioni arsimor, publik, publiko-privat, privat, fetar, personi juridik dhe fizik, nuk i mënjanon lëshimet dhe parregullsitë në afatin e caktuar në bazë të rekomandimit, inspektori i arsimit do të marrë vendim për iniciimin e procedurës adekuate sipas shkallës së cënimit të ligjit;

2.3. Në rastin e inspektimit emergjent nxirret vendim brenda ditës.

2.4. Inspektori i arsimit është i obliguar ta përcjellë zbatimin e rekomandimit apo vendimit.

3. Raporti për inspektimin pedagogjik përbëhet nga raporti fillestar dhe raporti përfundimtar:

3.1. Raporti fillestar me gjetje dërgohet për komente tek institucioni i inspektuar dhe DKA-ja përgjegjëse, jo më vonë se dy javë pas inspektimit.

3.2. Raporti përfundimtar duhet të përmbajë të gjeturat e inspektimit pedagogjik, përgjigjet/reflektimet e shkollës dhe DKA-së, këshillat dhe rekomandimet përfundimtare të inspektoratit arsimor dhe datën e një inspektimi pasues.

3.3. Raporti i vlerësimit të jashtëm do t'i prezentohet shkollës dhe DKA-së në një diskutim përmbyllës.

4. Raporti për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve përmban të dhënat për rezultatet individuale të mësimdhënësve të cilat vendosen në bazën e të dhënave të licencimit nga inspektorët pedagogjikë.

5. Raporti për vlerësimin e performancës për drejtor dhe zëvendësdrejtor përmban të dhëna për rezultatet individuale të vlerësimit të cilat raportohen në bazën e të dhënave të sistemit të licencimit dhe në DKA për vazhdim, mos vazhdim apo ndërprerje të kontratës.

Amandamenti 35

Neni 15 riformulohet në një paragraf të vetëm si në vijim:

Neni 15 Konfidencialiteti

Të gjitha informatat nga inspektimi do të trajtohen në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Amandamenti 36

Neni 16 riformulohet si në vijim:

Neni 16 Komisionet e ankesave

1. Drejtori i Inspektoratit për shqyrtim të ankesave nga fushëveprimtaria e Inspektoratit të Arsimit themelon komisione për:

1.1. Shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave në shkallë të dytë;

1.2. Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve – “Paneli i artë”.

Amandamenti 37

Pas nenit 16, shtohen tre (3) nene të reja si në vijim:

Neni 17 Komisioni për shqyrtim të ankesave dhe kërkesave

1. Komisioni për shqyrtim të ankesave përbëhet prej tre (3) anëtarëve dhe atë dy anëtarë të përhershëm njëri nga ta kryetar dhe një anëtarë caktohet nga rasti në rast.

2. Anëtari i tretë nuk mund të caktohet ekzaminuesi i lëndës;

Neni 18 Paneli i Artë

1. Komisioni “Paneli i Artë”, merret me shqyrtimin e ankesave në shkallë të dytë në procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.

2. Komisioni “Paneli i Artë” përbëhet nga tre (3) anëtarë, dy anëtarë të përhershëm njëri nga ta kryetar dhe një anëtarë caktohet nga rasti në rast.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të “Panelit të Artë” përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga MASHT.

Neni 19 Afati i ankesës

Afati për parashtrimin e ankesës është tredhjetë (30) ditë.

Amandamenti 38

Neni 17, titulli dhe paragrafi 1 riformulohet ndërsa nënparagrafet mbesin si në projektligj, si në vijim:

Neni 17

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare

1. Krahas përgjegjësive të parapara me legjislacionin për shërbimin civil, inspektori i arsimit është përgjegjës, nëse:

Amandamenti 39

Neni 19 riformulohet si në vijim:

Neni 19

Dokumentet profesionale dhe praktike të inspektimit

1. Për qëllime të inspektimit të përgjithshëm, administrativ dhe pedagogjik, si dhe të vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve, drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve përgatiten dokumente të unifikuara, që përfshijnë:

- 1.1. Formularët për njoftimin për inspektim të institucioneve arsimore, sipas nevojës, DKA-ve, duke përfshirë një listë dokumentesh që duhet të përgatiten për inspektim nga institucionet e inspektuara;
- 1.2. Instrumentet standarde të zhvilluara për vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve për procesin e licencimit;
- 1.3. Kornizën për vlerësim me fusha të përcaktuara të cilësisë së shkollës;
- 1.4. Manualin operacional;
- 1.5. Formularët e raportimit;
- 1.6. Formularët e vendimeve;

2. Inspektimet realizohen në mënyrë individuale apo ekipore varësisht nga lloji i inspektimit.

3. Inspektimet kryhen nga inspektorët e arsimit apo ekipe inspektuese, të cilat përbëhen nga udhëheqësi operativ i cili është inspektor i arsimit, së paku një inspektor tjetër dhe, sipas nevojës, ekspertë të jashtëm, sipas fushave të caktuara të inspektimit. Anëtarët e tjerë të një ekipi inspektues mund të jenë inspektorët e fushave të tjera që nuk mbulohen nga ky Ligj, si dhe përfaqësues të DKA-së dhe komunitetit.

4. Institucionet dhe autoritetet arsimore komunale obligohen të bashkëpunojnë me inspektorët e autorizuar arsimorë, të ofrojnë tërë dokumentacionin e nevojshëm, kushte për punë në institucion dhe do të sigurojnë praninë e personelit të autorizuar gjatë inspektimit.

Amandamenti 40

Në nenin 20, në titull fjala “**Etika**” dhe në paragrafin 1, fjala “**Vlerat**” zëvendësohet me fjalën “**Parimet**”

Neni 20 Parimet

1. Parimet themelore të Inspektoratit të Arsimit janë:

Amandamenti 41

Neni 20 paragrafi 4 riformulohet si në vijim:

4. Inspektori i arsimit dhe institucioni arsimor vendosin marrëdhënie pune të bazuar në profesionalizëm dhe mirëkuptim.

Amandamenti 42

Neni 20 paragrafi 5 fshihet.

Amandamenti 43

Neni 20 paragrafi 6 riformulohet si në vijim:

6. Inspektori i arsimit nuk inspekton institucionin ku ka konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi.

Amandamenti 44

Neni 21, riformulohet si në vijim:

Neni 21 Sanksioni kundërvajtës me gjobë

1. Sanksioni kundërvajtës me gjobë, mund të parashihet në shumë të përcaktuar ose në shumë të caktuar.
2. Me ligj sanksioni kundërvajtës me gjobë mund të parashihet në shumë të përcaktuar dhe atë:
 - 2.1. Në rast se është konstatuar shkelja nga paragrafi 1.3 i nenit 13 të këtij ligji, personi fizik dënohet në shumë prej njëmijë (1,000) deri në tremijë (3,000) euro, kurse personi juridik në shumë prej pesëmijë (5,000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000) euro.
 - 2.2. Në rast se është konstatuar shkelja nga paragrafi 1.9 i nenit 13 të këtij ligji, personi fizik dënohet në shumë prej njëmijë (1,000) deri në tremijë (3,000) euro, kurse personi juridik në shumë prej dhjetëmijë (10,000) deri në tredhjetëmijë (30,000) euro.
 - 2.3. Në rast se është konstatuar shkelja nga paragrafi 1.1 i nenit 13 të këtij ligji, personi fizik dënohet në shumë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, kurse personi juridik në shumë prej dymijë (2,000) deri në gjashtëmijë (6,000) euro.
 - 2.4. Në rast se është konstatuar shkelja nga paragrafët 1.4; 1.5; 1.6; 1.7; 1.8; 1.10; 1.11 dhe 1.12 të nenit 13 të këtij ligji, personi fizik dënohet në shumë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, kurse personi juridik në shumë prej njëmijë (1,000) deri në tremijë (3,000) euro.

2.5. Në rast se është konstatuar shkelja nga paragrafi 4 i nenit 19 të këtij ligji, personi fizik dënohet me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijëpesëqind (1,500) euro kurse personi juridik dymijë (2,000) deri në gjashtëmijë (6,000) euro.

2.6. Në rast se është konstatuar shkelja nga paragrafi 2.6 i nenit 10 të këtij ligji, personi fizik dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri në njëqindpesëdhjetë (150) euro.

3. Për shkeljet tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë ligj, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

Amandamenti 45

Neni 22 riformulohet si në vijim:

Neni 22 Mbyllja e institucionit arsimor

Inspektorati i arsimit e mbyllë institucionin arsimor i cili vepron në kundërshtim me vendimin e akreditimit dhe licencën që e posedon.

Amandamenti 46

Neni 23 riformulohet si në vijim:

Neni 23 Pagesa shtesë

1. Inspektorit të Arsimit i njihet e drejta e marrjes së pagës shtesë mbi pagën bazë në emër të rrezikshmërisë për kushtet specifike të punës.

2. Shtesat sipas paragrafit 1 të këtij neni do të bëhen sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil dhe Ligjit për pagat e nëpunësve civil.

Amandamenti 47

Neni 24 riformulohet si në vijim:

Neni 24 Aktet nënligjore

1. Ministria brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.

2. Aktet nënligjore në fuqi do të zbatohen deri në afatin i nxjerrjes së akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, nëse nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Amandamenti 48

Neni 25 fshihet.

3. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me përfundimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë(KKTK), mandat i cili përfundon më datë 23 korrik 2018.

Komisioni autorizon KKTK që të bëjë shpalljen publike për anëtar të KKTK, i cili në këtë proces ka rolin teknik në pranimin e aplikacioneve, ndërsa procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit, bëhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi